



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 29.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **25.07.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Exclusive Corporation SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me produkte për sëmundje të rënda dhe të rralla për SHSKUK” LOT 1** (Adalimumab), me nr. prokurimi **206-24-6260-1-1-1**, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Pranohet**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Exclusive Corporation SH.P.K.** e dt. 25.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me produkte për sëmundje të rënda dhe të rralla për SHSKUK” LOT 1**, me nr. prokurimi **206-24-6260-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 22.07.2024;
2. **Anulohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 22.07.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, e kthen në Ri-vleresim Lot-in 1 (Adalimumab) të aktivitetit të prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik **Exclusive Corporation SH.P.K.** me datën 25.07.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim për aktivitetin e prokurimit me titull **“Furnizim me produkte për sëmundje të rënda dhe të rralla për SHSKUK” LOT 1**, me nr. prokurimi **206-24-6260-1-1-1**. Autoriteti Kontraktues, me datën 29.07.2024 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

**Neni 1 i LPP-së**  
**Neni 7 i LPP-së**  
**Neni 59 i LPP-së**  
**Neni 60 i LPP-së**  
**Neni 62 i LPP-së**  
**Neni 69 i LPP-së**  
**Neni 72 i LPP-së**  
**Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.**  
**Neni 43 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.**

**Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet – pretendimet ankimore te OE ankues:**

Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

**ARSYETIM**

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ne ofertën e juaj për Lot 1 produkti Adalimumab, ju kemi ofertuar me normën e TVSH-se zero 0% ndërkohë që kontratën e kaluar të muajit mars 2024 me nr. 206-23-14029-1-1-1/C492 Lot 1, ju e kemi pasur me TVSH-ne 8%. Çmimin pa TVSH sipas kontratës së kaluar e kemi pasur 227.90 € ndërsa çmimin pa TVSH ne ofertën e tanishme e kemi ofruar 246.15 €, ose 18.25 € me shtrenjte për njësi.

Sipas kërkesës për tenderim me nr. Protokollit 05-4845 të hartuar nga Njësia e Kërkesës – Divizioni i Farmacisë në MSh, për Loti 1 vlera e parashikuar me TVSH 8% është parapare për njësi 246.15 € dhe në total 189,535.50 €, ndërsa oferta juaj është pa TVSH dhe si e tillë është saktësisht sa vlera e parashikuar për njësi 246.15 € dhe në total 189,535.50 €.

Duke marrë parasysh dallimin në çmimin bazë pa TVSH, në mes vlerës së parashikuar dhe ofertës tuaj, në këtë fazë pas hapjes së ofertave nuk mund të behet korrigjimi i vlerës së parashikuar dhe çmimi i ofruar pa TVSH është i pa ndryshueshëm dhe si i tillë është për 8% mbi vlerën e parashikuar nga AK-MSh.

Ky llot anulohet konform nenit 62 i LPP-se paragrafi 1.1 i cili thot:

L.L.një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Shih me poshtë një formë tabelare kërkesën për tenderim:

Emri	Forma farmaceutike	Çmimi perfundimtar me TVSH	Planifikimi dy vjeçar	Totali i vlerës fitqardare
Adalimumab <sup>3</sup>	Trecësiçë për injeksion në shiringë (ë parambushur; 40 mg/0.4 ml.) Indikacioni: morbus Crohn të rastet pediatrike dhe rastet adulte (në rast se ka dështuar terapia standarde), artriti kronik juve nil të shoqëruar me uetit dhe iridociklit <sup>4</sup> Ky bari është i përfshirë në konceptdokumentin për sëmundje të rraha	246.15	770	€ 189,535.50
Etisedipin	Pluhur për tretësirë orale; 0.75 mg/ml. Indikacioni: SMA	7,521.53	426	€ 3,201,171.78
				€ 3,391,707.28

Arsyeja e eliminimit është shumë abstrakte për ne, sidomos kur ceket tenderi i kaluar dhe çmimet e kaluara në tenderin paraprak.

Sa i përket TVSH-së që nuk e kemi vendos në këtë tender, ju sqarojmë se ne jemi informuar se produkti që duhet të furnizohet në këtë Lot Adalimumab është i liruar nga TVSH-ja dhe kjo mund të vërtetohet lehtë kur analizohet njoftimi në faqe të Ministrisë së Financave-Dogana e Kosovës, prandaj bashkangjitur kemi këtë dokument ku shihet që produkti Adalimumab është i liruar nga TVSH-ja.

Përderisa ky produkt është i liruar nga TVSH-ja, ne nuk mund të vendosim çmim me TVSH dhe



nuk mund të paguajmë TVSH ligjërisht, prandaj arsyeja e eliminimit është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme.

Vlera e parashikuar për produktin Adalimumab është 189,535.50 €, prandaj nga procesverbali i hapjes dhe nga formulari i tenderit shihet që oferta jonë është brenda vlerës së parashikuar dhe nuk ka nevojë të bëhet korrigjim i vlerës së parashikuar siç ka pretenduar autoriteti kontraktues.

Pra, pasi që nuk ka pas TVSH ky produkt, ne kemi ofertuar pa TVSH dhe për këtë arsye çmimi është vendosur njëjtë tek procesverbali i hapjes si dhe te rubrika e çmimit pa TVSH ashtu edhe tek rubrika e çmimit me TVSH.

Shih çmimi tek procesverbali i hapjes.

2.	" EXCLUSIVE CORPORATION " SH.P.K., Hilmi Rakovica Nr 43, 10000, Prishtine	206-24-6260-1-1-1	Lot 1- Furnizim me Adalimumab	PO	189535.50	189535.50	JO
----	---	-------------------	----------------------------------	----	-----------	-----------	----

Po ashtu edhe tek përshkrimi i çmimeve, çmimi i ofruar nga ne është i njëjtë, shih më poshtë:

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

PJESA /Lot	Artikulli	Përshkrimi/fortesia	Sasia për 24muaj	Çmimi për njësi Pa TVSH (€)	Norma e TVSH-së në (%)	Çmimi për njësi ME TVSH (€)	Çmimi Total ME TVSH (€)	Prodhuesi dhe Vendi i origjinës	Afati i liferimit (max. 30 ditë)
1	Adalimumab	Tretësirë për injeksion në shiringë të parambashur: 40 mg/0.4 mL Indikacion: morbus Crohn te rastet pediatrike dhe te rastet adulte (në rast se ka dështuar terapia standarde), artriti kronik juveneril të shoqëruar me uvellit dhe iridociklit *Ky bari është i përfshirë në konceptdokamentin për sëmundje të rralla	770	246,15 Eur	0%	246,15 Eur	189,535.50 Eur	Stada Arzneimittel(Pharm) AG Germany	30 Ditë

Neve na është kërkuar sqarime shtesë në lidhje me çmimin e ofruar, kurse ne me dt.19.07.2024 kemi dhënë sqarime:

Të nderuar,

1. Sa i përket kërkesës tuaj në lidhje me TVSH e produktit Adalimumab ju njoftojmë se gjatë procedurës së ofertimit të parë nga Kontrata 206-23-14029-1-1-1/C492 ky produkt ka qenë në listen e barnave që kanë TVSH, mirpo gjatë importit të këtij produkti me datë 04.04.2024 nga ana e shërbimit doganor të Kosovës na kanë njoftuar që produkti Adalimumab është produkt në listën e citostatikëve i cili është liruar nga TVSH konform Ankesit 01 nga Ministria e Financave dhe shërbimit doganor ( të cilin Aneks së bashku me produkte ju kemi dërguar në email me datë 02.05.2024).

Andaj në Kontratën e kaluar faturimi me këtë produkt është bërë si përherë konform çmimit final prej 246.15 Eur, pra me 0% TVSH sepse edhe në import nuk kemi pasur TVSH.

2. Sa i përket kërkesës në lidhje me TVSH-në e çmimit për produktin Adalimumab nga Tenderi me Nr të prokurimit: 206-24-6260-1-1-1, duke u bazuar në dosjen e tenderit në pikën 2.6 - Vlera e parashikuar për Lot 1 - Adalimumab është 189,535.50 Eur nga M.SH. për të cilën vlerë edhe kemi ofertuar duke përfshirë të gjitha detyrimet dhe taksat e importit, duke mos e tejkuluar vlerën e parashikuar nga M.SH.

Andaj si dokumente shtesë për sqarim në lidhje me këtë kërkesë po iu bashkangjesim:

ANKESIN 01 nga Ministria e Financave dhe listen e produkteve të liruara nga TVSH-ja në të cilën është edhe produkti Adalimumab.

Pra, kemi sqaruar se produkti në fjalë është produkt në listën e citostatikeve dhe i liruar nga TVSH-ja, e poashtu kemi bashkangjitur edhe Aneksin 01 tek faqja e informatave në Ministrinë e Financave-Dogana e Kosovës ku dëshmohet një gjë e tillë, mirëpo AK-së nuk e ka marrë parasysh këtë fakt, prandaj kërkojmë që me këtë kërkesë për rishqyrtim të merret parasysh sqarimi dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Sa i përket tenderit të kaluar, ne fillimisht kemi ofertuar me TVSH sepse nuk e kemi ditur se ky produkt është i liruar nga TVSH-ja deri në momentin e ofertimit, dhe më pastaj kur e kemi kuptuar në gjë të tillë edhe faturat i kemi dorëzuar pa TVSH dhe gjithçka ka qenë në rregull, prandaj arsyeja e tanishme e eliminimit nuk ka bazë ligjore.

Mbi bazën e dëshmive të cekura më lartë, rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të ulët. Faktikisht jemi kompania e vetme ofertuese në këtë tender.

Duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Në këtë aktivitet të prokurimit, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-



së.

Nuk është respektuar edhe neni i 7 i LPP-së, duke u diskriminuar ne si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi, kurse paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 dhe neni 6 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa në këtë rast është vepruar në kundërshtim me këto dispozita, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

#### VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **Exclusive Cooperation SH.P.K**  
**ANULOHET** njoftimi mbi vendimin (B58) për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

#### 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën paraofertuese.

#### Deklaratë shtesë PLOTESIM I KERKESES PER RISHQYRTIM , nga OE ankues:

Duke u bazuar në kërkesën për rishqyrtim të datës 25.07.2024 për produktin Adalimumab kërkojmë nga ju që sipas mundësive ta trajtoni këtë kërkesë me prioritet sa më shpejtë sepse jemi njoftuar nga prodhuesi se do të kemi rritje të kostos së furnzimit në ofertimet e radhës e cila do të na shkaktojë probleme neve si kompani në të ardhmen edhe deri në mos pjesëmarrje të ofertimit për shkak të kostos së lartë.

Andaj duke ditur rëndësinë dhe nevojën elementare për plotësim të kërkesave nga njësitë kërkuese të SHSKUK-së për produktin Adalimumab për të cilin produkt çmimi ynë në këtë aktivitet është mjaft i arsyeshëm për AK-MSH dhe është në minimumin e çmimit të tregut dhe mundësisë tonë për furnzim, andaj kërkojmë nga ana juaj mundësisht edhe njëherë ta trajtoni këtë kërkesë për rishqyrtim me prioritet në mënyrë që të mos ketë mungesë të furnzimit të produktit në fjalë,

### Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Konstatojme se pretendimet e juaja ankimore jane te bazuara, duke marre parasysh se vlera e parashikuar ne DT per Lot 1 – (Adalimumab) ka qene 189,535.50 € dhe ju keni ofertuar ne vleren e tenderuar 189,535.50 €.

Sa i perket pretenimit tuaj ne lidhje me arsyen e eliminimit per shkak t ndryshimit te normes se TVSH-se, verehet qe sipas njoftimit ne faqe te Ministrise se Financave – Dogana e Kosoves, ky produkt eshte i liruar nga TVSH-ja, andaj edhe ofertimi juaj me TVSH-nje zero (0) eshte i drejte.

Bazuar ne nenin 62 te LPP-se paragrafi 2.1 te arsya e përfundimit të aktivitetit të prokurimit, eshte se: të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit, ndersa oferta juaj është brenda vlerës se parashikuar.

Sa i përket çështjes se TVSH-se ekziston edhe një opinion i KRPP-se i datës **22.11.2022**

*Pyetja:*

*Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?*

*Përgjigja:*

*Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.*

Ky interpretim tregon qe OE nuk mund te refuzohet edhe ne raste kur bene gabime ne % te TVSH por duhet te korrigjohet, e ne rastin tuaj as kjo nuk qëndron, meqenëse TVSH zero (0) është ne rregull ne baze te normës se vendosur këtë vit nga Qeveria e RK.

Gjithashtu sipas nenit 40.10 te RPP:

- a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, **çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet. Ne rastin tuaj nuk ka mospërputhje ne oferte,** meqenëse kur shumëzohet sasia 770 x 246.15 (çmimi njësi) = 189,535.50 euro.

.Si AK-MSh pajtohem me pretendimet e juaja duke marre parasysh edhe faktin se produkti i juaj eshte i vetmi i regjistruar ne Kosove, prodhuesi eshte gjerman, eshte shume me rendesi te kemi furnizim per pacientet e caktuar dhe te mos kemi nderprerje te furnizimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



**Berat Marmullaku**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**